



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

2023/0051

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi - Anëtar, Agon Ramadani - Anëtar, Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE “JAGUAR SECURITY SH.P.K.”, kundër / lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut” me numër të prokurimit KEK-22-11947-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., më 12/04/2023, mori këtë:

VENDIM

- Aprovohet**, si e bazuar ankesa e JAGUAR SECURITY SH.P.K. me nr. 2023/0051, e datës 26/01/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut”, me numër të prokurimit KEK-22-11947-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..
- Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut”, me numër të prokurimit KEK-22-11947-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsytimit të dhëna nga paneli shqyrtues.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
- Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 26.01.2023, ka pranuar ankesë nga OE "Jaguar Security" sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut", me nr. të prokurimit: KEK-22-11947-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 51/2023.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë Autoriteti Kontraktues me datën 18.11.2022, ka publikuar Njoftim për Informata Shtesë ose përmirësim i Gabimit për tenderin sipër shënuar.

Me datë 22.01.2023, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 23.01.2023, AK Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "Jaguar Security" sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut".

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 07.02.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues "Jaguar Security" sh.p.k me seli në Prizren të aprovohet si e bazuar,

- AK të bëjë të plotësim/ndryshimin e kërkesës së dosjes së tenderit si dhe të bëhet zgjatja e afatit për ofertim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE Ankues - Jaguar Security Sh.P.K.

Pretendimi 1

I. Kontratat e realizuara brenda 3 viteve të fundit

1) Një listë të kontratave të realizuara nga tenderuesi në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Për këtë pikë është e çuditshme se si AK nuk ka kërkuar sipas LPP që të dëshmoj të paktën 1.5 herë të vlerës me referenca të përfunduara, pa dashur të paragjykojmë por këtu i jepet mundësia edhe një kompanie që është krjuar para një jave të aplikoj.

Përgjigje në pretendimin 1

Sa i përket këtij pretendimi AK i KEK ka bërë kërkesat e DT si që e parashef Ligji i Prokurimit Publik të Kosovës. Kriteret që është kërkuar tekniko profesional Lista e kontratave në tri vitet e fundit është në përputhje me nenin 69 të LPP-së dhe në bazë të këtij neni AK e ka atë drejten që në bazë të Listes së Referencave që ka paraqit në Listë të vertetohet të gjitha Referencat që i ka paraqit në Listë. Në bazë të kesaj eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi 2

Kërkesë tjetër që bie në kundërshtim me LPP-në dhe dosjen tenderike:

Kapaciteti Dëshmia e ekonomik kërkuar dhedokumentare: financiar:

AK nuk ka kërkuar asnjë lloj qarkullimi bankar apo përmes deklaratave tatimore të ATK-së.

Kjo gjë rrezikon në masë të madhë OE-të që kanë përvoja shumë vjetarë të rrezikon konkurrencën e barabartë. Ku LPP-ja i detyron që të kërkojnë AK-të të paktën 1.5 herë qarkullimit për të dëshmuar kapacitetin e ofertuesve në mënyrë që të demonstrojnë kapacitetet e tyre për të mund të realizojnë një projekt si ky në fjalë, përndryshe bëhet edhe rrezikimi i ekzekutimit të projektit dhe dështimi i sigurimit të objekteve.

Përgjigjeje në pretendim 2.

Në bazë të nenit 68 dhe 69 Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, dëshmit që i ka kërkuar AK-ja.

AK e ka të drejten në bazë të LPP-së dhe në bazë të RRPP kritere duhet të përzgjidhen si pas nevojës së Autoritetit Kontraktues dhe lëndës së kontratës. Kriteret e percaktuara në dosjen e tenderit duhet të lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontrates dhe jo me aftësinë e operatorëve Ekonomikë për të përmbushur kontratën.

Kriteret që përcaktohen në dosjen e tenderit duhet të formulohen në mënyrë të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshme për operatorët ekonomik në këtë rast në bazë të nenit 52 nenit 68 dhe 69 të LPP-së është e drejt e AK të përcaktoj në dosjen e tenderit dhe të hap konkurrencen sa më shumë.

Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimore është i pa bazuar.

Pretendimi 3

Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është:

Në rast se u jepet kontrata juve, para se ta nënshkruani kontratën, ju duhet të depozitoni një siguri të ekzekutimit në vlerë prej 50 % të vlerës së kontratës, për një periudhë të vlefshmërisë prej 30 ditë pas përfundimit të kontratës.

Një kërkesë e tillë është e papërballueshme për OE-të dhe e panevojshme pasi që sipas LPP-së i obligon AK-të që siguria e ekzekutimit të jetë 10% konform dispozitave ligjore vetëm në raste se ndonjë OE oferton me çmim jo-normalisht të ulët atëherë ka të drejtë AK që të rris atë deri në një përqindje tjetër qoftë edhe kjo 50%, mirëpo dihen rastet kur kjo përqindje (%) mund të kërkohet dhe jo në përgjithësi.

Përgjigjeje në pretendimin 3

Sa i përket këtij pretendimi ankimor nuk është e drejt e AK-së të kërkoj në dosjen e tenderit sigurimi e ekzekutimit 50% pasi me këtë kërkesë AK-ja ka larguar konkurrencën gjithashtu është në kundërshtim me kushtet e përgjithshme/veçanta të kontratës.

Në bazë të nenit 63 të paragrafi 2 i LPP-së të jetë i barabart apo me se paku 10% po e citojm nenin:

2. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që shuma e çfarëdo sigurie të ekzekutimit që kërkohet nga paragrafi I këtij neni:(i)të jetë e barabartë me së paku dhjetëpërqind(10%)të vlerës së kontratës dhe(ii) përndryshe është vendosur në një nivel që është në përputhshmëri me praktikat e zakonshme publike dhe afariste të aplikueshme ndaj llojit të veçantë dhe lëndës së kontratës përkatëse

Gjithashtu edhe në bazë të LPP-së dhe ne bazë të RRPP dhe UDHPP kjo kërkesë duhet të jetë vetëm 10% si kërkesë e dosje se tenderit.

AK këtë kërkesë mundet të kërkon nëse dyshojnë duhet të behët se një OE ka ardhur me çmim të lirë dhe nuk mundet te realizon kontratën atëherë mundet te ja kërkon sigurimin e ekzekutimit vetëm deri 30 % te vlerës se kontratës. Kjo kërkesë prej 50% te vlerës është kundërshtim edhe me parimet e prokurimit pasi bënë kufizimin e konkurrencës apo friksimin e OE gjithashtu me këtë kërkesë po dëmtohen edhe OE që janë serioz që nuk ka dyshime në realizim të kontratës.

Shih nenin 29.4 të RRPP

29.4 Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën10% të vlerës së kontratës, ndërsa të kontrata me çmim për njësi apo me poentim kërkohet10% e vlerës se parashikuar. Kur përcaktohet përqindja e sigurimit të ekzekutimit, në rast të kontratave me vlerë të mesme ose të madhe,AK do të siguroj që përqindja mjafton për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Autoriteti kontraktues,pasi që të jetë përputhur me nenin 61tëLPP-se,ka mjaft arsye për të besuar se Operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulët),gëzon të drejten që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata.

Ekspert shqyrtues mendojmë se pretendimi ankimor i OE është i qëndrueshëm pasi duhet të përdoret Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Neni 3

Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:

ni i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

mi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

ë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Pretendimi 4

Po ashtu buxheti i paraparë prej 2,691,148.98 euro mendojmë se është tejjetë i ulët krahasim me kërkesat e AK-së të cilat janë të shumta, mirëpo realizimi me këtë vlerë do të del i pamundur për të gjitha OE-të që mendojnë të ofertojnë.

Kërkesë tjetër e AK që është shumë e pa qartë është:

Duke marr parasysh rendësin e objekteve që duhet të ruhen si dhe nivelin e stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçantë për autoritetin kontraktues. Paga minimale bruto bazë (të pagesave shtesë dhe lejimeve konform Ligjit të Punës në fuqi), për roje fizike të angazhuar në këtë kontratë duhet të jetë jo më pak se 386.00€ në muaj. Ky çmim është për ndërrimin e parë. Kontraktori është i obliguar që të respektoj Ligjin e Punës dhe Udhëzimin Administrativ të MPMS Nr.09/2017. Në këtë rast Kontraktori obligohet të paguaj shtesë mbi pagën bazë për ndërrimin e dytë dhe të tretë dhe festa. Kontraktori obligohet të furnizoi edhe një shujtë të ngrohtë për çdo ndërrim.

Përgjigjeje në pretendimin 4

Sa i përket këtij pretendimi ankimor mendoj si ekspert se AK e ka bërë mirë llogaritjet e buxhetit në bazë të kërkesa të dosjes se tenderit që i ka parashtruar. Kërkesat që i ka parashtruar me pagë jo ma të vogël për punëtor 386 euro ne muaj, pagë për menaxherë jo me të vogël se 500.00 euro ky buxhet sipas një analize sipërfaqësore që unë e llogarita mjafton. Ky buxhet prej vlerës 2,691.148.98 euro është i alokuar vetëm për një vitë që mendoj duhet të jetë i mjaftueshëm.

Analiza sipërfaqësore:

$84 \text{ pika roje } 24 \text{ ore } \times 4 \text{ punëtor ne pikë } = 336 \text{ punëtor në muaj } \times 386 \text{ paga mujore} = 129,696.00 \text{ euro } \times 12 \text{ muaj} = 1,556,352.00 \text{ euro plus vlera tjetër për pagat e menaxherëve dhe sigurimi shëndetësor besoj se mjaftojnë buxheti i alokuar për një vitë prej 2,691.148.98 euro dhe në bazë të kësaj ky pretendim ankimor nuk është i bazuar.}$

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,

AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Konstatimet e panelit shqyrtues

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritot të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e palëve në proces, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Sa i përket pretendimit nr. 3, i cili është klasifikuar i bazuar, paneli shqyrtues mbështetet edhe në interpretimin e dhënë nga KRPP tek pyetja me nr.21, i cili citon “Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 63 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë sigurinë e ekzekutimit më të lartë se 10 % e vlerës së kontratës, por në asnjë mënyrë nuk mund të kërkojë sigurinë e ekzekutimit në shumën më pak se 10 % e vlerës së kontratës.

*Si rrjedhojë, paragrafi i lartë cituar përcakton vetëm minimumin e përqindjes së sigurisë së ekzekutimit, por jo edhe maksimumin e përqindjes së tillë. Pavarësisht nga kjo, Autoriteti Kontraktues mund të përcaktojë një përqindje më të lartë se 10 % e vlerës së kontratës gjithnjë duke qenë në proporcion me shumën e dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata. Barra e provës në këtë rast i takon AK-së që të argumentojë në mënyrë të saktë dhe të arsyetuar mjaftueshëm përqindjen (më të lartë se 10%) e sigurisë së ekzekutimit të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, si dhe të sigurojë se një përqindje e tillë nuk bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik (ekonomiciteti dhe efikasiteti, transparenca, konkurrenca, trajtimi i barabartë, jo diskriminimi). **Pra, Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet në asnjë mënyrë të përcaktojë një përqindje të lartë të sigurisë së ekzekutimit, nëse me këtë kufizon konkurrencën e operatorëve ekonomik, diskriminon dhe/ose favorizon ndonjë operator ekonomik.”***

Andaj, PSH konsideron se AK nuk ka vepruar konform parimeve të LPP-së dhe interpretimit të dhënë nga KRPP sepse një kërkesë e tillë mund të kufizon konkurrencën e operatorëve ekonomik, diskriminon dhe/ose favorizon ndonjë operator ekonomik. Po ashtu edhe kërkesa e tillë e cila është kërkuar në Dosje të Tenderit është jashtë praktikave të cilën e kanë përdorur autoritetet kontraktues deri më tani dhe nuk konsiston as me natyrën e aktivitetit të prokurimit por edhe proporcionin e dëmeve dhe shpenzimeve të parapara në rast të shkëputjes eventuale të kontratës.

Andaj, AK duhet të bëjë përmirësimin e Dosjes së Tenderit dhe në harmoni të plotë me dispozitat dhe parimet e LPP-së.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

1x1 OE - **JAGUAR SECURITY SH.P.K.**

1 x 1 Arkivës së OSHP-së:

1 x 1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së

